



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. Regj.Them 5714 31004-05334-80-2015
Datë. Regj. 04.09.2015

Nr. vendimi _____
Datë vendimi 10.11.2015

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS ”

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e përbërë prej :

GJYQTARE : SELVIE GJOÇAJ

Asistuar nga sekretare gjyqësore Anisa Zoto, në Tiranë, sot më datë 10.11.2015, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen administrative Nr. 5714 31004-05334-80-2015 Akti, që i përket:

PADITËS:

Instituti Shqiptar i Shkencave, organizatë jofitimprurëse e krijuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.3048/2011, e përfaqësuar nga Drejtoria Ekzekutive znj. Aranita Brahaj, me adresë: Rruga “Asim Vokshi” Pall.13/25, kati 3, Tiranë, me numër telefoni 068 20 01 718, përfaqësuar në gjykim nga Av. Viktor Gumi Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë me nr. Lic. 1848 Nipt L41309003G, i caktuar sipas autorizimit datë 01.10.2015 (ne mungese ne seancen e shpalljes se vendimit).

TË PADITUR:

Komisioneri për Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me adresë: Rruga e Kavajës, ndërtesa 80, hyrja 1, Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga Znj Jonida Dalipaj dhe Z. Eldi Sherifi, të caktuar sipas autorizimit nr. 675/6 prot, datë 05.10.2015.

Partia Socialiste e Shqipërisë, me adrese: Sheshi “Austria” nr. 91, Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga Z. Gledian Llatja i caktuar sipas autorizimit nr. 142 prot, datë 05.10.2015 (ne mungese ne seancen e shpalljes se vendimit).

Partia Demokratike e Shqipërisë me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, nr.11, Tiranë (në mungesë).

Lëvizja Socialiste për Integrim me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Godina 20/10, Tiranë, (në mungesë).

OBJEKTI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 44, datë 22.07.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Detyrimin e partive politike t'i japë palës paditëse informacionin e kërkuar për financimin e fushatës zgjedhore, të kërkuar prej këtij të fundit në datën 09.06.2014.

BAZA LIGJORE:

Neni 9, paragrafi i trete i Kushtetutës, neni 2/c, neni 3 dhe neni 25 i ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe neni 11, 15/d, 16, 17/a/% dhe neni 18 i ligjit nr.49/2012 "Për Gjykatën Administrative".

Në përfundim të hetimit gjyqësor të çështjes, të zhvilluar në prani të perfaqësuesit të paditësit, të perfaqësuesve të paleve të paditura Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenve Personale dhe Partia Socialiste e Shqipërisë, në mungesë të paleve të paditura Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Levizja Socialiste për Integrim, Gjykata, pasi degjoi palet prezent, të cilat përfundimisht kërkuar:

Përfaqësuesi i paditësit Insituti Shqiptar i Shkencave: Pranimin e kërkesë padisë sipas objektit;

Përfaqësuesit e palës së paditur Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenve Personale: Rrezimin e kërkesë padisë, si e pabazuar në ligj dhe në prova;

Përfaqësuesi i palës së paditur Partia Socialiste e Shqipërisë: Rrezimin e kërkesë padisë, si e pabazuar në ligj dhe në prova;

si dhe pasi analizoi provat e paraqitura nga palet dhe bisedoi çështjen në teresi,

VËREN SE:

Paditësi Insituti Shqiptar i Shkencave ka paraqitur përpara Gjykatës një kërkesë padi me objekt: "Shfuqizimin e vendimit nr. 44, datë 22.07.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Detyrimin e partive politike t'i japë palës paditëse informacionin e kërkuar për financimin e fushatës zgjedhore, të kërkuar prej këtij të fundit në datën 09.06.2014".

Gjykata, bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile, konstatoi kryesisht se kjo çështje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe bazuar në nenet 7, 10/1 dhe 11/2 të ligjit nr. 49/ 2012 ' Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative', Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është kompetente nga pikpamja lëndore, funksionale dhe tokësore për shqyrtimin gjyqësor të saj.

Bazuar në parashikimet e nenit 12/1 të ligjit nr. 49/ 2012 ‘ Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ çështja u mor në shqyrtim nga trup gjykues i përbere nga një gjyqtar.

Gjithashtu, bazuar në parashikimet e nenit 79/a të K.Pr.Civile, kërkesë padia dhe aktet ju njoftuan dhe Avokturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë, e cila me shkresë deklaroi mospjesëmarrjen, duke ia deleguar te drejten e perfaqësimit organit shtetëror.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se:

Paditësi Insituti Shqiptar i Shkencave është person juridik, organizate jofitimpruese, e krijuar në bazë të vendimit nr. 3048, datë 28.03.2011 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka per objekt veprimtarie, nder te tjera: ” *Promovim dhe inicim i informacioneve dhe inisativave ligjore apo qytetare me qëllim njohjen, garantimin dhe respektimine te drejtave te individeve dhe gupeve sociale. Sensibilizimi mbi tema që lidhen me ceshtje te sigurise qeverisjes dhe bashkejeteses sipas parimeve dhe kriterëve te vendosura nga legjislacioni kombetar e legjislacioni europian etj*”. Më datë 09.06.2015, paditësi u është drejtuar me kërkesë subjekteve zgjedhore Partia Socialiste e Shqiperise, Partia Demokratike e Shqiperise dhe Levizja Socialiste per Integrim duke i kërkuar secilit të japë informacion për:

- a) *Listen e dhuruesve te fondeve publike që kane perfituar prej datës 21 Maj 2015 dhe që mbi shumen 100 000 (njëqind mije) lekë ose sherbime apo sende te barazvlefshme me to;*
- b) *Listen e çdo shpenzimi që kanë kryer eventualisht prej datës 21 Maj 2015 me fondet vjetore te perfituara nga buxheti i shtetit 2015*”.

Ndonëse subjektet zgjedhore kane marre dijeni per kerkesen per informacion, fakt ky i provuar nga te dhenat e deftesave postare perkatese, nuk i janë përgjigjur paditësit. Në këto kushte, referuar parashikimeve te nenit 24 të ligjit 119/2014 “Për të drejten e informimit”, paditësi ka paraqitur ankese pranë Komisionerit për të Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te dhenave Personale, duke i kërkuar te detyroje subjektet zgjedhore te japin informacionin e kërkuar per financimin e fushates zgjedhore sipas kërkeses se tij. Komisioneri për të Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dhenave Personale, me vendimin nr. 44, datë 22.07.2015, ka vendosur:’ *Rrezimin e ankeses nr. 675 prot, datë 09.07.2015 te Insitutit shqiptar te Shkencave. Kunder ketij vendimi ankuesi ka te drejten e ankimit ne Gjykatën Administrative kompetente ne perputhje me nenin 25 te ligjit 119/2014 “Per te drejten e informimit*’. Ky vendim i është komunikuar paditësit me shkresen nr 675/2 prot, datë 22.07.2015. Paditësi, pasi ka marrë dijeni, i është drejtuar gjykatës më kerkesë padine objekt gjykimi.

Gjatë hetimit gjyqësor të çështjes dhe në perfundim te tij ne kuadrin e pretendimeve perfundimtare, përfaqësuesi i paditësit Insituti Shqiptar i Shkencave parashitroi këto pretendime:

Kërkesë padia bazohet në nenin 9, paragrafi 3 i Kushtetutës, si dhe në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, neni 2, shkronja c dhe neni 3 i tij. Në të kundërt me atë paraqitet në vendimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, partitë

politike-subjektet zgjedhore në zgjedhje, në mbështetje të nenit 2/c të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit” janë autoritete publike, sepse:

- Shteti ka marrë përgjegjësi për funksionin në fjalë;
- Shteti ka rol thelbësor në marrëdhënien me subjektin e çështjes në shqyrtim;
- Ekziston interesi publik në çështjen në fjalë;
- Ekzistojnë parashikime ligjore ose detyrimi në raport me çëshjen në fjalë;
- Shteti ka pranuar që në mënyrë të drejtpërdrejtë të rregullojë, mbikqyrë ose inspektojë performancën e funksionit në fjalë;
- Shteti kryen pagesa për funksionin në fjalë;
- Ekzistojnë masa në të cilën mund të përfshihet fuqia shtrënguese e shtetit;
- Kryerja jo e rregullt e funksionit të transparencës prej subjekteve zgjedhore shkel të drejtat e individëve të njohura nga Kushtetuta dhe nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Nga ana tjetër, kërkesa jonë është edhe thjeshtësisht e realizueshme nga ana praktike. Subjektet zgjedhore listën e donacioneve mbi 100 000 lekë mund ta përfitojnë vetëm nëpërmjet rrugës bankare dhe për të mundësuar përgjigjen në kohë të kërkesës tonë, mjafton vetëm një print i veprimeve të bëra në llogarinë bvankare përkatëse. Sipas nenit 90, paragrafi i dytë i Kodit Zgjedhor “Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posacme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për cdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së”. Po ashtu, neni 91 i Kodit Zgjedhor saknsionon detyrimin e partive politike, të rregjistruara si subjekte zgjedhore, të bëjnë transparencën e financimeve të përfituara dhe jo kandidatët përkatës për kryetarë të bashkive apo anëtarë këshillash bashkiakë. Gjithashtu edhe shpenzimet e bëra gjatë fushatës zgjedhore të kërkuara nga paditësi kërkojmë vetëm një fotokopje nga listat e llogarive të mbajtura sipas parimeve të kontabilitetit. Partitë politike kërkesës sonë nuk i kanë dhënë asnjë përgjigje. Ato injoruan tërësisht kërkesën dhe për më tepër nuk kërkon as kohë shtesë dhe as na paraqitën ndonjë pretendim objektiv në lidhje me pamundësinë e përmbushjes së kërkesës tonë. Ato thjesht nuk e morën në konsideratë kërkesën e paraqitur për transparencën e financimeve zgjedhore jopublike të përfituara prej tyre, duke treguar kështu mungesën e vullnetit politik në këtë drejtim.

Bazuar në keto argumenta, përfaqësuesi i paditësit kërkoi pranimin e kërkesë padisë sipas objektit.

Gjatë hetimit gjyqësor të çështjes dhe në perfundim të tij në kuadrin e pretendimeve perfundimtare, përfaqësuesit e palës së paditur Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenve Personale parashtruan këto prapësime:

Pala paditëse e bazon kërkesë padinë e saj në nenin 9 paragrafi 3 të Kushtetutës dhe nenin 2/c të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ndër këto referenca ligjore, veprimtaria e Zyrës së Komisionerit i nënshtrohet parashikimeve të këtij të fundit, ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ndërsa nuk mund të shtrijë analizën tejet

këtij ligji. Në këtë frymë është shqyrtuar dhe arsyetuar vendimmarrja objekt gjykimi. Vendimmarrja nuk zgjidh konflikte ligjore, por synon t'i qëndrojë strikte kërkesave të ligjit/eve mbi të cilën ky institucion ushtron veprimtarinë e punës së tij. Sipas nenit 9/3 të Kushtetutës burimet financiare të partive dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike. Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", vërtet nga njëra anë ka parashikuar se të drejtën për informacion publik e gëzon çdo person siç është edhe rasti i paditësit, por nga ana tjetër ligjvënësi ka parashikuar se për të përfituar marrjen e informacionit të administruar apo prodhuar nga një autoritet publik, duhet që ky i fundit të jetë i tillë në përputhje me kategoritë dhe kërkesat e përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji. Në shkronjën 'c' të këtij neni përcaktohet qartazi se, autoritet publik në funksion të ligjit për të drejtën e informimit është çdo person fizik ose juridik por që me ligj, akt nënligjor apo çdo lloj forme tjetër duhet të ketë parashikuar të drejtën e ushtrimit të funksioneve publike. Ky është elementi që kushtëzon të qënurit autoritet publik në kuptim të këtij ligji dhe për rrjedhojë kushtëzon edhe mbajtësin e informacionit në dhënien e tij edhe Komisionerin në ushtrimin e kompetencës ligjore për të urdhëruar dhënien e informacionit publik Referuar parashikimit në shkronjën "c" të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", partitë politike janë persona juridikë, por nuk përmbushin elementin lidhës, ushtrimin e funksioneve publike, që i bën ata të detyrohen të zbatojnë ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit". Për të provuar të kundërtën, pala paditëse nuk paraqiti gjatë këtij procesi gjyqësor asnjë ligj apo akt nënligjor të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që përcakton dhënien e kësaj të drejte "ushtrimit të funksioneve publike" këtyre subjekteve. Mungesën e këtij përcaktimi ligjor e evidenton edhe neni 1 i ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, i cili jep përkufizimin e partive politike, "*Partitë Politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilat synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura në pushtet*". Nga ky përkufizim kuptohet se partitë politike në vetvete nuk kryejnë/ushtrojnë asnjë funksion publik. Ato për nga natyra ngjasojnë me organizatat jofitimprurëse edhe pse një pjesë e tyre/partive politike financohen nga buxheti i shtetit por nuk kryejnë funksione publike.

Bazuar në keto argumenta, përfaqësuesit e palës së paditur kërkuan rrezimin e kërkesë padisë, si e pabazuar në ligj dhe në prova.

Gjatë hetimit gjyqësor të çështjes dhe në perfundim të tij në kuadrin e pretendimeve perfundimtare, përfaqësuesi i palës së paditur Partia Socialiste e Shqipërisë parashtrroi këto prapësime:

Për sa i përket legjitimitetit aktiv, pala paditëse nuk ka legjitimitet aktiv për të thirrur Partinë Socialiste si subjekt zgjedhor në këtë proces pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, pasi subjektet zgjedhore e ushtrojnë aktivitetin e tyre në bazë të Kodit Zgjedhor, i cili është është një ligj i posaçëm dhe parashikon procedura specifike. Në asnjë rast një subjekt zgjedhor nuk mund të paditet në Gjykatën Administrative, pasi është subjekt i një tjetër gjykate, Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Në rast se PS do të paditej si parti politike, absolutisht që padia do të ngrihej pranë gjykatës së shkallës së parë, pra në një tjetër juridiksion gjyqësor.

Për sa i përket legjitimitetit pasiv, ashtu sic e pranon dhe pala paditëse, i vetmi ent publik, i cili është thirrur si palë e paditur, në asnjë rast nuk i ka dërguar një shkresë apo ka nxjerrë një akt, i cili është drejtuar partive politike.

Partia Socialiste e Shqipërisë ashtu si edhe partitë e tjera organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për partitë politike". Në nenin 1 të këtij ligji jepet përcaktimi i partive politike, të cilat në vetvete janë bashkim vullnetar i shtetasve me qëllim ndikim në jetën politike të vendit dhe janë një faktor shumë i rëndësishëm i demokracisë dhe i jetës demokratike të një vendi. Partitë politike e zhvillojnë aktivitetin e tyre në zbatim të Kushtetutës së RSH, ligjit për partitë politike, Kodit Zgjedhor dhe ligjeve e akteve nënligjore në fuqi.

Pala paditëse ka kërkuar një informacion pranë partive politike kur ato gëzonin statusin e subjektit zgjedhor, por në asnjë moment nuk e ka kërkuar këtë informacion pranë institucionit përgjegjës KQZ, i cili disponon në kohë reale informacionin e kërkuar prej saj. Kodi Zgjedhor i ka të rregulluar shumë qartë marrëdhëniet e KQZ me subjektet zgjedhore dhe madje për mosrespektimin e dhënies së informacionit për financimin e partive, ka parashikuar edhe sanksionet përkatëse. Partia Socialiste gjithnjë ka qënë e hapur dhe transparente me financimet e saj, madje në këto moment sapo ka përfunduar edhe auditin financiar i KQZ dhe të gjitha informacionet e dhëna pranë KQZ janë të certifikuara edhe nga audituesi i caktuar nga organi kompetent. Në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të aksesohen shumë lehtë nga cdokush informacioni i kërkuar nga paditësi. Ky institucion ka një praktikë të sajën në dhënien e informacionit për financimin e partive politike dhe në publikimin e raporteve të auditit, ku ato shqyrtohen në një mbledhje të hapur për publikun dhe materiali është paraprakisht i aksesueshëm në faqen e internetit ose mund të merret me shumë lehtësi pa pagesë, edhe nëse kërkohet fizikisht pranë këtij institucioni. Paditësi ka kërkuar gabim, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave personale detyrimin e subjekteve të cilët marrëdhëniet e tyre i rregullojnë me një ligj të posaçëm, ku janë të specifikuara shumë qartë procedurat dhe institucionet përgjegjëse për mbledhjen e këtij informacioni dhe ku ky institucion nuk ka asnjë tagër ligjore. Pra, informacioni i kërkuar gabim nga paditësi është paraqitur nga të gjithë subjektet zgjedhore pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe gjithçka është publike, si nga partitë politike ashtu edhe nga KQZ, pasi ky detyrim lind nga Kushtetuta e RSH.

Bazuar në keto argumenta, përfaqësuesi i pales se paditur kërkoi rrezimin e kërkesë padisë, si e pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Gjykata, duke pasur parasysh pretendimet dhe prapësimet e palëve, provat e paraqitura pre tyre si dhe parashikimet ligjore, çmon se kërkimi i paditësit Insituti Shqiptar i Shkencave është i pabazuar. Në vijim po parashtrrojme argumentat:

Së pari, gjykata çmon se pretendimi i paditësit sipas te cilit, ne kuptim te nenit 2/1/c te ligjit 119/2014 'Per te drejten e informimit', paditësi është një autoritet publik është i pabazuar. Në kuptim te ketij neni "Autoritet publik" është çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike. Ne rastin konkret, ne kuptim te nenit 1 te ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Per partite politike", partite

politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve, e të pikepamjeve ose të interesave të përbashketa politike, të cilat synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nepermjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Ndryshe nga sa pretendon pala paditëse, ushtrimi i funksionit publik nga ky lloj personi juridik duhet të jetë rrjedhojë e parashikimit të shprehur të ndonjë ligji, akti nënligjor, apo në çdo formë tjetër. Në rastin konkret nuk rezultojnë të ketë një parashikim të tillë të shprehur për partitë politike si person juridik. Pra, në këtë rast e drejta e ushtrimit të funksionit publik nuk është çështje interpretimi, por parashikimi të shprehur. Në këto kushte gjykata e gjetë të bazuar vendimin nr. 44, datë 22.07.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale në bazë të të cilit është rrefuzuar kërkesa e paditesit për detyrim të paleve të paditura për dhenien e informacionit të kërkuar me argumentin se ato nuk janë autoritet publik.

Së dyti, vendimi i palës së paditur Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale nuk bie në kundërshtim me parashikimet në nenin 9/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit të posaçëm për partitë politike. Menyra e përmbushjes së detyrimit kushtetues nga partitë politike për berjen publike të financimeve dhe shpenzimeve të tyre në rastet e fushatave zgjedhore është parashikuar në Kodin Zgjedhor, pjesën VII të tij "Financimi i zgjedhjeve dhe i fushatës". Referuar parashikimeve të nenit 87/2 të këtij Kodi, sasia e fondit publik që i shpërndahet secilit subjekt zgjedhor caktohet me vendim të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. Në Kod janë detajuar rregullat për mënyrën e shpërndarjes dhe rishpërndarjes së këtyre fondeve publike për subjektet zgjedhore, sasitë e tyre, detyrimi për t'i kthyer ato në raste të caktuara etj. Po kështu, në këtë pjesë të Kodit janë parashikuar dhe rregullat e financimit të subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike, modalitetet e realizimit, kufizimet përkatëse për sa i përket personave financiarë, shumat e financimit etj. Kështu, për sa u përket fondeve jopublike të përfituar nga persona fizik apo juridik, në këtë Kod është parashikuar detyrimi për subjektet zgjedhore për mbajtjen e një regjistri të posaçëm (miratuar si model me vendim të KQZ), ku pasqyrohen të dhënat e dhuruesve dhe shumat përkatëse. Ndërkohë që për financimet jopublike me vlerë mbi 100 000 lekë, ligji ka parashikuar detyrimin e kalimit të këtyre shumave nepermjet llogarive bankare, të hapura nga subjekti zgjedhor për këto qëllime, numer i ciles bëhet publik në faqen zyrtare të KQZ. Po kështu, referuar parashikimeve të nenit 90 të Kodit Zgjedhor dhe shpenzimet e subjekteve zgjedhore në fushatë zgjedhore dokumentohen. Nga teresia e këtyre parashikimeve ligjore rezultojnë që financimet publike dhe jopublike të subjekteve zgjedhore dokumentohen, po kështu dhe shpenzimet e tyre. Në vijim të gjithë këto praktike dokumentare është objekt auditimi nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, në përfundim të të cilit hartohet raporti përkatës, i cili bëhet publik. Vlen të theksohet se në këtë Kod janë parashikuar dhe sanksionet përkatëse në rast shkeljeje të parashikimeve ligjore në lidhje me financimin e fushatës zgjedhore. Pra, nga teresia e këtyre parashikimeve ligjore garantohet respektimi i detyrimit kushtetues dhe atij ligjor të posaçëm për berjen publike të financimeve dhe shpenzimeve të subjekteve zgjedhore. Rrjedhimisht, për sa kohë që, në bazë të këtyre parashikimeve ligjore ekzistojnë struktura dhe mjetet përkatëse për marrjen e informacionit të kërkuar, gjykata çmon se vendimi objekt gjykimi nuk ka cenuar të drejtën kushtetuese dhe ligjore të paditesit për të marrë

informacionin e kerkuar. Në keto kushte kerkesa padia është e pabazuar e si e tille duhet rrezuar.

Së trettë, për sa u përket shpenzimeve gjyqësore gjykata çmon se, perderisa kerkese padia rezultoi e pabazuar, këto shpenzime duhet t'i ngarkohen paditesit. Keto shpenzimet perbehen nga shpenzimet e verifikuara, te renditura në fund të këtij vendimi.

Në përfundim, duke pasur parasysh gjithë sa më sipër u citua, gjykata çmon se kerkese padia e paditesit është e pabazuar në ligj dhe në prova e si e tille duhet rrezuar.

PER KETO ARSYE :

Bazuar në nenet 40, 41 të ligjit nr. 49/ 2012 ' Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative'.

VENDOSI :

- Rrëzimin e kerkese padisë se paditësit Insituti Shqiptar i Shkencave, të paditur Komisioneri për te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenve Personale, Partia Socialiste e Shqiperise, Partia Demokratike e Shqiperise dhe Levizja Socialiste per Integrim, me objekt: "Shfuqizimin e vendimit nr. 44, datë 22.07.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Detyrimin e partive politike t'i japë palës paditëse informacionin e kërkuar për financimin e fushatës zgjedhore, të kërkuar prej këtij të fundit në datën 09.06.2014", si e pabazuar ne ligj dhe ne prova.
- Shpenzimet gjyqësore ne ngarkim te paditësit.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes. Për palët ne mungese, ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit.
- Vendimi t'u komunikohet palëve ne mungese.
- U shpall në Tiranë, më 10.11.2015.

SEKRETARE
ANISA ZOTO

GJYQTARE
SELVIE GJOÇAJ

Shpenzime gjyqësore

Taksë gjyqësore 3000 lekë

Njoftime gjyqësore 1400 lekë

Gjithsej 3400 lekë